

L I G J I

PER TE PUNESUARIT NE SEKTORIN PUBLIK

(“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numer 27/14; 199/14; 27/16; 35/18 dhe 198/18; ”Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24)

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Lenda e Ligjit

Neni 1

Me keteligi rregullohen parimet e pergjithshme, klasifikimi i vendeve te punes, evidenca, llojet e punesimeve, te drejtat e pergjithshme, detyrat dhe pergjegjesite, mobiliteti, si dhe ceshtje tjera te pergjithshme per te punesuarit ne sektorin publik.

Punedhenesit dhe te punesuarit ne sektorin publik

Neni 2

(1) Punedhenes ne sektorin publik (netekstin e metejme: institucione), ne pajtim me kete ligj, jane:

- organet e pushtetit shteteror dhe lokal, dhe organet tjera shteterore te themeluara ne pajtim me Kushtetuten dheme ligj dhe
- institucionet te cilat kryejneveprime nga sfera e arsimit, shkences, shendetesise, kultures, punes, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes se femijes, sportit, si dhe ne veprimtari tjera meinteres publik te percaktuar me ligj, ndersa te organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndermarrje publike te themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat ne Qytetine Shkupit.

(2) Te punesuar ne sektorin publik jane personat te cilet kane themeluar marredhenie pune te ndonje prej punedhenesve nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Funksonaret, perkatesisht personat te cilet kane fituar mandat qe tekryejne funksion ne zgjedhje presidenciale, parlamentare ose lokale, personat te cilet kane fituar mandat te kryejne

funksiione ne pushtetin ekzekutiv ose gijyqesor nepermjet zgjedhjes dhe emerimit nga Kuvendi i Republikes se Maqedonise se Veriut ose nga organet e pushtetit lokal, si dhe personat tjere te cilet nepajtim me ligjin jane zgjedhur ose emeruar ne funksion nga bartesit e pushtetit ligjvenes, ekzekutiv ose gijyqesor, ne kuptim te ketij ligji, nuk konsiderohen te punesuar ne sektorin publik.

Zbatimi i Ligjit

Neni 3

(1) Per te punesuarit ne sektorin publik zbatohen dispozitat e ketij ligji, dispozitat e ligjeve te vecanta, rregullat e miratuara ne baze te ketij ligji dhe ligjeve te vecanta dhe memorreveshjet kolektive.

(2) Per ceshtjet te cilat nuk janerregulluar me kete ligj, si dhe per ceshtjet per te cilat ky ligj nuk sugjeron zbatim te ligjit te vecante dhe te marreveshjes kolektive, ndersa kane te bejneme marredheniet e punes te te punesuarit, zbatohen rregullat e pergjithshme per marredheniet e punes.

(3) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, per personelin ushtarak dhe civil ne sherbim ne Armaten e Republikes se Maqedonise se Veriut, per personat e autorizuar zyrtare ne Ministrine e Mbrojtjes, ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe ne organin ne perberje te Ministrise se Puneve te Brendshme-Byrojne per Siguri Publike, ne Agjencine per Siguri Nacionale, ne Agjencine per Zbulim, si dhe ne organin ne perberje te Ministrise se Financave-Drejtorine e Policise Financiare, do te zbatohen vetem dispozitat nga kapitujt III dhe IV te ketij ligji.

(4) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni per personelin ndihmes-teknik zbatohet neni 5, si dhe dispozitat nga Kapitulli III, Kapitulli IV, IV-a dhe VII te ketij ligji, kurse per ceshtjet tjera ne lidhje me marredhenien e punes zbatohen rregullat e pergjithshme per marredheniet e punes dhe marreveshjet kolektive.

KAPITULLI II

PARIMET E PERGJITHSHME PER TE PUNESUARIT NE SEKTORIN PUBLIK

Parimi i ligjshmerise

Neni 4

Te punesuarit ne sektorin publik kryejne punet dhe detyrat e punes ne pajtim me Kushtetuten, ligjin, rregullat tjera ne baze te ligjit dhe marreveshjeve te ratifikuara nder kombetare ne pajtim me Kushtetuten.

Parimi i kushteve te barabarta, qasja e barabarte ne vendin e punes, perfaqesimi i drejte dhe adekuat

Neni 5

- (1) Institucionet, ne pajtim me parimin e kushteve te barabarta dhe qasjes se barabarte per te gjithë kandidatet e interesuar ne vendin e punes, kane per obligim qe vendet e lira te punes dhe kushtet per plotesimin e tyre t'i shpallin nepermjet shpalljes interne, perkatesisht publike.
- (2) Institucionet kane per obligim qe t'i planifikojne punesimet ne pajtim me nevojat e tyre, dhe ne baze te Metodologjise per planifikim te punesimeve ne sektorin publik ne pajtim me parimin per perfaqesim te drejte dhe adekuat.
- (3) Metodologjine per planifikim nga paragrafi (2) i ketij neni, qe i permban formen, permbajtjen dhe formularin e planit vjetor dhe raporti per realizimin e planit vjetor per punesim e miraton ministri i Administrates Publike ne pajtim me ministrin e Marredhenieve ndermjet Bashkesive.

Parimi i profesionalizmit dhe kompetences

Neni 6

- (1) Punesimi ne sektorin publik kryhet nepermjet publikimit te shpalljes publike, me c' rast ne procedure transparente, te drejte dhe konkurrencte te seleksionimit, zgjidhet kandidati me profesional dhe me kompetent per vendin e punes.
- (2) Avancimi ne sektorin publik, kryhet nepermjet publikimit te shpalljes interne, me c' rast ne procedure transparente, te drejte dhe konkurrencte te seleksionimit, ne te cilen ne baze te vleresimit per rezultatin, profesionalizmin dhe kompetencen, zgjidhet kandidati me i mire per vendin e punes nga radhet e te punesuarve ne institucion.
- (3) Procedura e seleksionimit nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni per caktohet me ligj, ndersa perbehet nga kontrolli i deshmive te paraqitura per plotesimin e kushteve per vendin e punes, dhenien e testeve kualifikuese ne forme ne leter apo elektronike, organizimin e intervistave, dhe/ose forma tjera te kontrollit te kandidateve.

Parimi i menaxhimit me rezultatin e te punesuarve

Neni 7

- (1) Institucionet detyrohen te vendosin procedura per menaxhim me rezultatin e te punesuarve nepermjet perqelljes se tij te vazhdueshme dhe vleresimit dhe propozimit te masave per permiresimin e tij.
- (2) Vleresimi per rezultatin eshte mase per kontributin e te punesuarit per funksionim efikas dhe efektiv te institucionit, qe matet nepermjet kualitetit, dinamikës, respektimit te afateve,

nivelit të plotësimit të qëllimeve dhe detyrave të punës, orientimit në servis, profesionizmin dhe sjelljen e të punësuarit, si dhe në përmbajtjet e tjera me interes për institucionin.

(3) Vlerësimi nga paragrafi (2) i këtij neni është bazë për: zmadhimin ose zvogëlimin e rrogës së të punësuarit, përcaktimin e shpërblimit në para ose shërbimit material ose jo material, avancimin ose sistemin në vend të punës në nivelin më të ulët, ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Parimi i orientimit në servis

Neni 8

(1) Të punësuarit në sektorin publik punët dhe detyrat e punës kryejnë në mënyrë të cilësore, të përgjegjshme, profesionale, në kohë dhe të ndërgjegjshme, në pajtim me rregullat e profesionit dhe afatet dhe procedurat në pajtim me ligjin.

(2) Të punësuarit në sektorin publik janë me orientim në servis, përkatesisht aktive, inovative, kooperative dhe fleksibile me qëllim të realizimit të efikas dhe efektiv të të drejtave dhe të interesave të paleve, me kujdes të njëkohshëm për interesin publik.

(3) Të punësuarit në sektorin publik, detyrohen të sigurojnë dergjim përkatës të paleve të shërbimeve kompetente, për realizim të të drejtave të tyre dhe të interesave.

Parimi i etikës profesionale, përaanshmerisë dhe objektivitetit

Neni 9

(1) Gjate kryerjes së punëve dhe të detyrave të punës, të punësuarit në sektorin publik mbajnë standarde të lartë për integritet personal, etikë profesionale dhe kujdes për mbrojtjen e interesit publik dhe u përmbahen akteve të cilat i rregullojnë këto standarde.

(2) Të punësuarit në sektorin publik gjate kryerjes së punëve dhe të detyrave të punës sigurojnë zbatim të përaanshëm dhe objektiv të ligjeve dhe rregullave të tjera, me c'rast qytetarëve dhe personave juridikë u mundësojnë mbrojtje dhe realizim të të drejtave, e kjo të mos jetë në dëm të qytetarëve dhe personave të tjerë juridikë, as në kundërshtim me interesin publik, të përcaktuar me ligj.

(3) Të punësuarit në sektorin publik punët dhe detyrat e punës kryejnë me përaanshmeri politike, pa ndikimin e bindjeve të veta politike dhe interesave financiare personale.

(4) Të punësuarit në sektorin publik i respektojnë qëllimet, interesat, prestigjin dhe integritetin e institucioneve në të cilat janë të punësuar.

Parimi i transparences dhe besueshmerise

Neni 10

(1) Te punesuarit ne sektorin publik gjate kryerjes se puneve dhe te detyrave te punes detyrohen te sigurojne qasjete informatat me karakter publik, ne menyre dhe ne kushte te percaktuara me ligj.

(2) Te punesuarit ne sektorin publik ne kryerjen e puneve dhe te detyrave te punes ne vendin e punes, me te dhenat personale, zyrtare dhe te klasifikuarave projne ne menyre dhe ne kushte te percaktuara me ligj.

Parimi i pergjegjesise

Neni 11

Te punesuarit ne sektorin publik pergjigjen para institucionit ne te cilin jane punesuar per pasojat perveprimin e tyre, mosveprimit ose vendimmarrjen, perkatesisht mosvendimmarrjen, si dhe per kualitetin, kryerjen ne kohe dhe ne menyre efikase te kompetencave te besuara.

Parimi i pengimit te konfliktit te interesave

Neni 12

Te punesuarit ne sektorin publik nuk e shpien interesin personal material dhe material ne konflikt me interesin publik, dhe me statusin e tyre i cili mundte shkaktoje konflikt te interesave, ne pajtim me dispozitat e ketij ligji ose te ligjit tjetër.

Parimi i shfrytezimit te mjeteve ekonomikesht

Neni 13

Te punesuarit ne sektorin publik mjetet materiale, pajisjen dhe mjetet tjera per pune i shfrytezojne ne menyre ekonomike, te arsyeshme dhe efikase.

KAPITULLI III

KLASIFIKIMI I VENDEVE TE PUNES NE SEKTORIN PUBLIK

Grupet dhe nengrupet e vendeve te punes ne sektorin publik

Neni 14

(1) Ne institucionet e sektorit publik, vendet e punes per te punesuarit grupohen ne menyren ne vijim, edhe ate:

grupi I - vende pune te nepunesve administrative, perkatesisht personave te cilet kane themeluar marredhenie ne institucionet e sektorit publik, per kryerje te puneve te natyres administrative,

grupi II - vende punete personave zyrtare me autorizime te vecanta, perkatesisht personave te cilet kane themeluar marredhenie pune ne institucionet e sektorit publik nga sfera esigurise, mbrojtjes dhe zbulimit per kryerje te autorizimeve te vecanta,

grupi III - vende punete dhenesve te sherbimeve publike, perkatesisht personave te cilet kane themeluar marredhenie pune ne institucionet e sektorit publik, per kryerje te puneve te lidhura me veprimtarite me interes publik ne pajtim me ligjin, te cilat nuk jane te natyres administrative dhe

grupi IV - vende punete personave ndihmes-teknike, perkatesisht personave te cilet kane themeluar marredhenie pune ne institucionet e sektorit publik per mirembajtje, sigurim, kryerje te transportit, si dhe pune tjera ndihmese dhe teknike me te cilat sigurohet funksionimi i papenguar i institucioneve.

(2) Ne suazat e cdo grupi percaktohen nje ose me shume nengrupe te vendeve te punes, si vijon:

1) grupi I - vende pune te nepunesve administrative (ne te gjitha institucionet e sektorit publik):

- nengrupi 1 - nepunes shtetore, perkatesisht lloj tjetër i nepunesve te percaktuar me ligje te vecanta dhe
- nengrupi 2 - nepunes publike,

2) grupi II - vende pune te personave zyrtare te autorizuar nga sfera e sigurise, mbrojtjes dhe zbulimit:

- nengrupi 1 - persona zyrtare te autorizuar ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe ne organin ne perberje te Ministrise se Puneve te Brendshme - Byroja e Sigurise Publike,
- nengrupi 2 - persona zyrtare te autorizuar ne njesine organizative pergjegjese per siguri dhe zbulim ushtarake ne Ministrine e Mbrojtjes,
- nengrupi 3 - persona zyrtare te autorizuar ne Agjencine per Zbulim,
- nengrupi 4 - persona zyrtare te autorizuar ne institucionet ndeshkuese-permiresuese dhe edukuese-permiresuese,
- nengrupi 5 - policia gjyqesore,

- nengrupi 6 – policia e prokurorise publike,
- nengrupi 7 - policia e pyjeve,
- nengrupi 8 - persona zyrtare te autorizuar ne organin ne perberje te Ministrise se Financave
- Drejtoria e Policise Financiare,
- nengrupi 9 - personeli ushtarak dhe civil ne sherbim ne Armaten e Republikes se Maqedonise se Veriut,
- nengrupi 10 - persona zyrtare te autorizuar ne Agjencine per Siguri Nacionale dhe
- nengrupi 11 - persona tjere zyrtare te autorizuar ne fushen e sigurise, mbrojtjes dhe zbulimit, te percaktuar me ligj,

3) grupi III- vende pune te dhenesve te sherbimeve publike ne institucionet publike, ndermarrjet publike te themeluara nga Republika e Maqedonise se Veriut, nga komunat, nga qyteti i Shkupit ose nga komunat e qytetit te Shkupit:

- nengrupi 1 – dhenesit e sherbimeve publike ne fushen e shendetesise,
- nengrupi 2 - dhenesit e sherbimeve publike ne fushen e arsimit dhe shkences,
- nengrupi 3 - dhenesit e sherbimeve publike ne fushen e punes, puneve sociale dhe mbrojtjes se femijeve,
- nengrupi 4 - dhenesit e sherbimeve publike ne fushen e kultures dhe informimit publik,

Службен весник на РСМ, бр. 143 од 12.7.2019 година

- nengrupi 5 - dhenesit e sherbimeve publike ne fushen e veprimtarive komunale dhe te veprimtarive tjera per te cilat jane themeluar ndermarrjet publike dhe

4) grupi IV - vende pune te personave ndihmes-teknike (ne te gjitha institucionet e sektorit publik):

- nengrupi 1 - persona ndihmes teknike per mirembajtjen e objekteve dhe pajisjes,
- nengrupi 2 - persona ndihmes teknike per sigurimin e objekteve dhe pajisjes,
- nengrupi 3 - persona ndihmes teknike per transportin e personave dhe pajisjes,-
- nengrupi 4 - personat ndihmes teknike ne kuzhine ose ne objekt hotelierik dhe - nengrupi 5
- persona tjere ndihmes teknike.

Kategorite dhe nivelet e vendeve te punes nesektorin publik

(1) Ne suaza te cdo nengrupi nga neni 14 paragrafi (2) i ketij ligji, percaktohen nje ose me shume kategori te vendeve te punes.

(2) Ne suaza te cdo kategorie te vendeve te punes, percaktohen nje ose me shume nivele te vendeve te punes.

(3) Nivelet e vendeve te punes pershkruhen me tituj, perkatesisht me emer profesional ose shkencor, me c'rast niveli me i ulet ne kategori eshte niveli hyres.

(4) Kategorite dhe nivelet nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij nen i percaktohen ne ligjet e vecanta dhe me marreveshjet kolektive ne pajtim me llojin e kualifikimeve profesionale te nevojshme dhe kompetencat e punes, pergjegjesine, llojin dhe nderlikueshmerine e puneve dhe te detyrave te punes, si dhe ne pajtim me kriteret tjera me rendesi per vendin e punes.

Katalogu i puneve ne sektorin publik

Neni 16

(1) Katalogu i vendeve te punes ne sektorin publik (ne tekstin e metejme: Katalogu) eshte liste e sistematizuar e vendeve te punes ne sektorin publik, te organizuara ne grupe, nengrupe, kategori dhe nivele.

(2) Katalogun e mban Ministria e Administrates Publike.

(3) Vendet e punes ne Katalog regjistrohen me shifer si shenje unike per vendin e punes, si dhe nengrupi, kategoria dhe niveli ku ben pjese vendi i punes.

(4) Pervec se me shifren, vendet e punes ne Katalog mund te pershkruhen edhe me titullin, perkatesisht me emrin profesional ose shkencor.

(5) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes se Katalogut, menyren e caktimit te shifrave te vendeve te punes, si dhe menyren e futjes dhe shlyerjes se vendeve te punes nga Katalogu, i percakton ministri i Administrates Publike.

Akte per organizim dhe sistematizim te brendshem te vendeve te punes

Neni 17

(1) Me aktin per organizim te brendshem, per cdo institucion ne sektorin publik, percaktohet lloji dhe numri i njesive organizative dhe fusheve primare te tyre te punes, me c'rast pjese perberese eshte pasqyra grafike e organizimit te institucionit (organogrami).

(2) Me aktin per sistematizimin e vendeve te punes, per cdo vend pune ne institucionin e sektorit publik, percaktohet grupi, nengrupi, kategoria dhe niveli ku ben pjese vendi i punes, si dhe kushtet e pergjithshme dhe te vecanta dhe pershkrimi i puneve dhe te detyrave te punes per cdo vend pune.

(3) Institucionet pergatisin dhemiratojne akt per organizim te brendshem dhe akt per sistematizimin e vendeve te punes, qe i perfshijne njesite organizative dhe vendet e punes te te gjithete punesuarve, ne pajtim me grupet e vendeve te punes te percaktuara ne keteligj.

(4) Institucionet i miratojne aktet nga paragrafi (3) i ketij neni pas analizes se realizuar funksionale, te bazuar ne deshmi. Ne institucionin ne te cilin per shkak te procesit te integritetit te Republikes se Maqedonise se Veriut ne Bashkimin Evropian, perkatesisht per shkak te detyrimeve te ndermarra nga projektet e BE-se ka nevojte per sistematizim te me shume vendeve te punes sesa qe eshte percaktuar ne paragrafin (5) te ketij neni, numri i vendeve te sistematizuara te punes percaktohet ne pajtim me analizen funksionale, te miratuar nga Ministria e Administrates Publike dhe nga organi kompetent per buxhetin

(5) Ne aktin persistematizimin e vendeve te punes mund te sistematizohen me se shumti 10% vendet e punes me teper se vendet e punes per te cilat jane siguruar mjete financiare per rroga dhe kompensime ne buxhetin e institucionit, pervec ne institucione me pak se 30 te punesuar, ne te cilat mund te jene te sistematizuar ne 50 vende pune, nese ka rritje te kompetencave te institucioneve ne pajtim me ligjin kurnumri ne vendet e punes percaktohet ne pajtim me analizen funksionale me teper.

(6) Ne aktet persistematizim, vendet e punes te personave te autorizuar zyrtare nga sfera esigurise, mbrojtjes dhe zbulimit, te keshilltareve te vecante dhe te nepunesvete kabineteve, mund te shenohen si te vecanta, me c' rast te njejtat nukevidentohen ne Katalog.

(7) Aktin per organizim te brendshem dhe aktin per sistematizimin e vendeve te punes, personi udheheqes i institucionit e miraton me pelqim paraprak nga Ministria e Administrates Publike lidhur me harmonizimin e tyre te ndersjelle si dhe me harmonizimin e tyre me dispozitat e ketij ligji, si dhe nga organi kompetent per dhenien e pelqimit te aktit te percaktuar meligj ose me rregull tjetere lidhur me harmonizimin e tyre me ato ligje oserregulla.

(8) Me perjashtim nga paragrafi (7) i ketij neni, Armata e Republikes se Maqedonise se Veriut, Ministria e Puneve te Brendshme dhe organi ne perberje te Ministrise se Puneve te Brendshme, Byroja e Sigurimit Publik, Agjencia per Siguri Nacionale, Agjencia per Zbulim, organi ne perberje te Ministrise se Financave-Drejtoria e Policise Financiare per personat zyrtare te autorizuar, gjykatat dhe prokurorite publike e percaktojne organizimin e brendshem, perkatesisht formacionin, si dhe sistematizimin e vendeve te punes sipas ligjeve te vecanta ose rregullave tjera, ndersa pa pelqimin paraprak te Ministrise se Administrates Publike.

(9) Permbajtjen dhemenyren e pergatitjes se akteve nga paragrafi (3) i ketij neni, si dhe permbajtjen e analizes funksionale nga paragrafi (4) te ketij neni e percakton ministri i Administrates Publike.

KAPITULLI IV

EVIDENCA E TE PUNESUARVE NE SEKTORIN PUBLIK

Regjistri i te punesuarve ne sektorin publik

(1) Per menaxhim unik dhe kualitativme resurset njerezore ne nivel te institucionit, perkatesisht ne nivel tesektorit publik, themelohet Regjistri i te punesuarve ne sektorin publik (netekstin e metejme: Regjistri), i cili nepermjet sistemit te informacionit permenaxhim me resurse njerezore (ne tekstin e me poshtem: SIMRNJ) e vendos edhe forme elektronike e mban Ministria e Administrates Publike.

(2) Ministria e Administrates Publike do te mundesoje qasje te SIMRNJ ne te gjitha institucionet nesektorin publik nepermjet dorezimit te emrit shfrytezues dhe fjalekalimi perpersonin e autorizuar nga funksionar i cili udheheq me institucionin.

(3) Ministria e Administrates Publike ka te drejte t'i perpunoje te dhenat e permbajtura ne Regjistrin e te Punesuarve ne sektorin publik dhe obligim te kryeje shkembim te te dhenave nga evidenca e vet me te dhena nga Agjencia e Punesimit te Republikes se Maqedonise se Veriut, Drejtoria e te Hyrave Publike dhe Fondi i Sigurimit Shendetesor dhe Pensional te Maqedonise se Veriut, ne drejtim te kryerjes se kontrollit dhe sigurimit te te dhenave te plota, te sakta dhe te azhurnuara me kohe nga ana e institucioneve ne sektorin publik.

(4) Formen dhe permbajtjen e Regjistrit, menyren e mbajtjes se tij, menyrene qasjes, shfrytezimin, perpunimin e te dhenave, si dhe menyren e sigurimit tepergjegjesise per autenticitet dhe siguri te te dhenave, i percakton ministri i Administrates Publike.

Te dhenat ne Regjister

Neni 19

(1) Regjistri i permban te dhenat ne vijim per te punesuarit ne sektorin publik:

- te dhena personale (emrin dhembiemrin, emrin e njerit nga te dy prinderit, gjinine, NUAQ, datelindjen, vendlindjen, komunen e lindjes, shtetin, perkatesine e bashkesise, adresen ejeteses, vendbanimin, komunen e jeteses, e-mailin dhe telefonin),
- te dhena per punesimin rrjedhesdhe punesimet paraprake (grupi, nengrupi, kategoria, niveli, vendi i punes),
- te dhena per arsimin, kualifikimetprofesionale dhe kompetencat e punes,
- te dhena per vleresimet vjetore,
- te dhena per proceduren e ngriturdisiplinore, pergjegjesine materiale, proceduren e ngritur kundervajtese osepenale,
- te dhena per mobilitet,
- te dhena per lartesine e rrogesdhe te kompensimeve te rroges dhe
- te dhena tjera per te punesuarin.

(2) Regjistri, krahas te dhenave ngaparafrasi (1) i ketij neni, permban edhe te dhena lidhur me statusin, emrin, kompetencen, perkatesisht veprimtarine, seline, strukturen organizative, vendet e punes dhe te dhenat tjera lidhur me institucionet ne sektorin publik.

(3) Me perjashtim nga parafrasi (1) i ketij neni, per personelin ushtarak dhe civil ne sherbim te Armatës se Republikes se Maqedonise se Veriut, per personat e autorizuar zyrtare ne Ministrine e Mbrojtjes, ne Ministrine e Puneve te Brendshme dhe ne organin ne perberje te Ministrise se Puneve te Brendshme-Byrone per Siguri Publike, ne Agjencine per Siguri Nacionale, ne Agjencine per Zbulim, si dhe ne organin ne perberje te Ministrise se Financave-Drejtorene e Policise Financiare, ne Regjister permbahen vetem te dhenat per numrin e pergjithshem te ketyre te punesuarve.

(4) Te dhenat personale te permbajtura ne Regjister perpunohen dhe ruhen nepajtim me rregullat per mbrojtjen e te dhenave personale.

(5) Funksonari i cili udheheq me institucionin eshte i obliguar te autorizoj se paku nje person per menaxhim me SIMRNJ, kurse nese behet fjale per institucion te sapoformuar ne afat prej dy muajsh nga dita e themelimit te institucionit dhe per ate ne afat prej pese ditesh e njofton Ministrine e Administrates Publike

(6) Ministria e Administrates Publike eshte e obliguar ne afat prej pese ditesh nga pranimi i njoftimit nga parafrasi (5) i ketij neni ne adresë elektronike te personit te autorizuar nga institucioni t'i dorezoje emershfrytezuesi dhe fjalekalim per qasje te SIMRNJ.

(7) Personi i autorizuar nga parafrasi (5) i ketij neni eshte i obliguar t'i vendose, respektivisht kompletoje te dhenat ne Regjistrin e SIMRNJ j, me se voni nje muaj nga dita e pranimi te temrit shfrytezues dhe fjalekalimit nga parafrasi (6) i ketij neni, si dhe ta azhurnoj cdo ndryshim te ndodhur te te dhenave ne afat prej 10 ditesh ne ngandodhja e tij.

Raport vjetor per te dhenat nga Regjistri

Neni 20

(1) Ministria e Administrates Publike pergatit Raport vjetor per te dhenat nga Regjistri.

(2) Raporti vjetor i permban te dhenat ne vijim:

- numrin, llojin, emrin, degen e pushtetit, veprimtarine dhe themeluesin - per institucionin e sektorit publik dhe

- numrin, grupet, nengrupet, kategorite, nivelet, titujt, vendet e punes, gjinine, moshen, nivelin e arsimimit dhe perkatesine e bashkesise - per te punesuarit ne sektorin publik.

(3) Te dhenat nga parafrasi (2) i ketij neni, kur kjo eshte e mundur dhe e logjikshme, paraqiten me kryqezim tendersjelle.

(4) Raporti nga parafrasi (1) i ketij neni mund te permbaje edhe te dhena plotesuese dhe informacione me te cilat disponon Regjistri varesisht nga qellimet e percaktuara me kete ligj dhe rregullat per mbrojtjen e te dhenave personale.

(5) Raporti publikohet ne ueb faqen e Ministrine e Administrates Publike deri ne fund te tremujorit te pare te vitit rrjedhes, pervitin kalendarik paraprak.

Kapitulli IV-a

PUNESIMI NESEKTORIN PUBLIK

Planet vjetore per punesime

Neni 20-a

(1) Punesimet ne institucionete sektorit publik kryhen ne baze te planeve vjetore per punesim (ne tekstin e metejme: plane), te cilat funksionaret te ciletudheheqin me institucionet i pergatisin ne baze te Metodologjise nganeni 5 paragrafi (3) i ketij ligji.

(2) Plani per punesimpergatitet ne nivel te institucionit dhe permбан:

- te dhena te saktaper gjendjen e plotesimit te vendeve te punes ne institucion,
- te dhena per pensionimet e planifikuara dhe te dhena per levizje tjera te planifikuara te te punesuarve (mobilitet ne suazate institucionit dhe/ose sektorit publik, avancime e te tjera) dhe
- plan per ndarjen e numrit te punesimeve tereja ne vitin vijues sipas perkatesise se bashkesise.

(3) Ne institucionetpublike edukative arsimore, te arsimit te larte dhe shkencore-hulumtuese, neinstitucionet publike per perkujdesje dhe edukim te femijeve te moshesparashkolllore, si dhe ne teatrot nacionale, ne te cilat veprimtaria ne pajtimme ligjin kryhet ne gjuhen maqedonase, perkatesisht ne gjuhen e pjesetareve tebashkesive qe nuk jane shumice ne Republiken e Maqedonise se Veriut, plani nga paragrafi(2) nuk permбан te dhena per shperndarjen e numrit te punesimeve te reja teplanifikuara per dhenesit e sherbimeve publike sipas perkatesise se bashkesise.

(4) Ne institucionet esektorit publik te cilat jane themeluar nga ana e pushtetit qendror dhe tecilat veprimtarine, perkatesisht kompetencen e kryejne ne nivel qendror dhe/osepermes njesive rajonale ose njesive tjera organizative ne nivel lokal, si bazeper shperndarjen e numrit te punesimeve te reja te planifikuara sipasperkatesise se bashkesise, merren te dhenat nga regjistrimi i zbatuar i funditi popullsise se Republikes se Maqedonise se Veriut per territorin e tere Republikes se Maqedonise se Veriut.

(5) Ne institucionet e sektorit publik qe janethemeluar nga ana e pushtetit qendror ose lokal, dhe te cilat veprimtarine,perkatesisht kompetencen e kryejne ne nivel lokal ose rajonal, si baze persherperndarjen e numrit te punesimeve te reja te planifikuara sipas perkatesises bashkesise,

merren te dhenat nga regjistrimi i zbatuar i fundit i popullsisese Republikes se Maqedonise se Veriut per njesine e veteqeverisjes lokale ne te cileneshte vendosur ai institucion.

(6) Shperndarja e numrit te punesimeve te reja te planifikuara sipas perkatesise se bashkesise kryhet ne menyre te percaktuarne Metodologjine nga neni 5 paragrafi (3) i ketij ligji, dhe ajo duhet tekontribuoje per zvogelim gradual te dallimit pozitiv ose negativ ndermjetgjendjes momentale te perfaqesimit ne institucion dhe baze per shperndarje ngaparagrafet (4) dhe (5) te ketij neni, perkatesisht per mbajtjen e perfaqesimitte drejte dhe adekuat.

Proceduraper miratimin e planit

Neni 20-b

(1) Funksonari i cili udheheq me institucionin eshte i detyruar qe me se voni deri me 1 shtator ne vitin rrjedhes, te perpiloje propozim-plan, te cilin bashke me propozim- kerkesen buxhetore e dorezon per pelqim te organi kompetent per buxhetin e institucionit, perkatesisht ne:

- Ministrine e Financave, per institucionet shfrytezues buxhetore te linjes se pare qe financohen nga Buxheti i Republikes se Maqedonise **se Veriut** dhe per ndermarrjet publike te themeluara nga Republika e Maqedonise **se Veriut**,

- ministrine kompetente, per institucionet qe kryejne veprimtari nga sfera e arsimit dhe shkences, shendetesise, kultures, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes se femijes, si dhe ne veprimtari tjera me interes publik te percaktuar me ligj,

- Keshillin e Komunes per njesite e veteqeverisjes lokale dhe ndermarrjet publike dhe institucionet e themeluara nga njesite e veteqeverisjes lokale dhe

- organ tjetet nese eshte percaktuar me ligj.

(2) Organet kompetente per buxhetin e institucionit jane te detyruara qe te japin pelqim, perkatesisht te japin verejtje ne lidhje me propozim-planin me se voni ne afat prej nje muaji nga pranimi i propozim-planit.

(3) Funksonari i cili udheheq me institucionin eshte i detyruar qe te veproje sipas verejtjeve te dhena nga organi kompetent per buxhetin, perkatesisht ta harmonizojte propozim-planin.

(4) Pas marrjes se pelqimit, perkatesisht pas harmonizimit te propozim-planit, funksionari i institucionit eshte i detyruar qe menjehere, e me se voni ne afat prej nje muaji nga marrja e pelqimit, perkatesisht pas harmonizimit te propozim-planit ta miratoje planin dhe te njejtin ta dorezoje per mendim ne **Ministrine e Administrates Publike**.

(5) Me perjashtim te paragrafit (1) te ketij neni, funksionari i institucionit per te cilin nuk ka organ i cili jep pelqim per buxhetin, planin vjetor e miraton dhe e dorezon per mendim ne **Ministrine e Administrates Publike**, me se voni deri me 1 shtator.

(6) Me perjashtim te paragrafit (4) te ketij neni, nese behet fjale per organ te administrates shteterore, funksionari eshte i detyruar qe menjehere pas harmonizimit te propozim-planit me organin kompetent per buxhetin, e me se voni ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes se pelqimit, perkatesisht pas harmonizimit te propozim-planit te kerkoje pelqim nga **Ministria e Marredhenieve Ndermjet Bashkesive**, per te cilin i njejt eshte i detyruar qe t'i pergjigjet ne afat prej 15 ditesh, perkatesisht te jape pelqim nese sistematizimi i punesimeve te reja te planifikuara sipas perkatesise se komunitetit eshte bere ne pajtim me nenin 20-a paragrafi (6) i ketij ligji ose te jape verejtje ne lidhje me planin.

(7) Ne rastet nga paragrafi (6) i ketij neni, funksionari eshte i detyruar qe menjehere, e me se voni deri me 1 nentor ta dorezoje planin e harmonizuar per mendim ne **Ministrine e Administrates Publike** nese plani vjetor eshte perpunuar ne pajtim me Metodologjine.

(8) **Ministria e Administrates Publike** eshte e detyruar qe ne afat prej nje muaji te veproje per kerketat nga paragrafet (4), (5) dhe (7) te ketij neni dhe te jape mendim, me c'rast nese konstatohet se plani nuk eshte harmonizuar me mendimin e organit kompetent per buxhetin, dhe/ose nese sistematizimi i punesimeve te reja te planifikuara sipas perkatesise se komunitetit nuk eshte bere ne pajtim me nenin 20-a paragrafi (6) i ketij ligji, mendimi do te jete negativ dhe institucionit do t'i jape afat plotesues prej 15 ditesh nga dita e mendimit te marre qe te dorezoje plan te harmonizuar.

(9) Nese edhe pas skadimit te afatit nga paragrafi (8) i ketij neni funksionari i institucionit ne **Ministrine e Administrates Publike** nuk dorezon plan te harmonizuar dhe nuk merr mendim pozitiv, institucioni nuk do te mund te zbatoje procedure per punesime te reja.

(10) Nëse organi kompetent për buxhetin e institucionit ose **Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive** ose **Ministria e Administratës Publike** nuk veprojnë sipas kërkesës për pelqim në afatet e përcaktuara në paragrafet (2), (6) dhe (8) të këtij neni, do të konsiderohet se pelqimi është dhënë.

(11) Planit për të cilin është marrë mendim pozitiv nga **Ministria e Administratës Publike** mund të ndryshohet gjatë vitit me të cilin ka të bëjë vetëm pas pelqimit të marrë paraprak nga organet kompetente për dhënie pelqim.

(12) **Ministria e Administratës Publike** është e detyruar që përfundimisht më 31 dhjetor në vitin rrjedhës t'i dorëzojë mendimet pozitive për planet e institucioneve për vitin e ardhshëm në organet kompetente për buxhetin e institucioneve dhe në Agjencinë për Administratë, ndërsa për organet e administratës shtetërore edhe në **Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive**.

Raportet për realizimin e planit

Neni 20-v

(1) Institucionet dyherë në vit njoftojnë për realizimin e planeve, për çfarë funksionari i cili udhëheq me institucionin, me se voni deri më 15 korrik për periudhën janar -qershor në vitin rrjedhës, përkatësisht me se voni deri më 15 janar për periudhën korrik-dhjetor në vitin paraprak, deri në raport me të dhëna të saktë për realizimin e planit të **Ministria e Administratës Publike**.

(2) Organet e administratës shtetërore raportet nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzojnë në **Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive**.

(3) **Ministria e Administratës Publike** është e obliguar, me se voni deri më 1 tetor për periudhën janar-qershor në vitin rrjedhës, përkatësisht me se voni deri më 1 mars për periudhën korrik - dhjetor në vitin paraprak, të përpilojë dhe të dorëzojë të Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut raport gjysmëvjetor për realizimin e planeve vjetore i cili përmban të dhëna për numrin e punësimeve të planifikuara dhe numrin e punësimeve të realizuara në institucionet e sektorit publik për institucion.

Shpallja publike dhe fletëparaqitja për punësim

Neni 20-g

(1) Për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit, institucioni është i obliguar të publikojë shpallje publike.

(2) Kandidatet për punësim paraqiten në shpalljen publike përmes plotësimit të fletëparaqitjes dhe paraqitjes së deshmive për plotësimin e kushteve për vendin e punës.

(3) Komisioni për seleksionim është i obliguar në afat prej tre ditësh nga skadimi i afatit për paraqitje në shpallje të kontrollojë nëse kandidatet i kanë dorëzuar deshmite e detyrueshme për plotësimin e kushteve nga shpallja, nëse me ligj të vecantë nuk është rregulluar ndryshe.

(4) Nese gjatekontrollit percaktohet se mungon ndonje nga deshmite, institucioni eshte iobliguar te kerkoje nga kandidati ne afat prej tri ditesh t'i kompletojedeshmite, nese me ligj te vecante nuk eshte rregulluar ndryshe.

(5) Pas kompletimit tedeshmive, Komisioni per seleksionim kryen kontroll te autenticitetit tedeshmive.

(6) Nese Komisionidyshon ne autenticitetit te cilesdo nga deshmite, i njejti eshte i obliguar tedorezoje kerkese per kontrolle plotesuese tek organi, perkatesisht institucionii cili e ka leshuar deshmine, i cili eshte i obliguar ne afat prej 10 ditesht'i pergjigjet.

(7) Nese gjatekontrollit percaktohet se deshmia eshte e rrejshme, Komisioni e hedh poshtefleteparaqitjen dhe e njofton Ministrine e Administrates Publike, e cila e udheheq Regjistrin e personave te cilet kane dhene tedhena te rrejshme gjate punesimit ne sektorin publik.

(8) Kandidati i cili kadorezuar deshmi te rrejshme per plotesimin e kushteve nuk mund te punesohet nesektorin publik ne periudhe prej dhjete vitesh nga dita e njoftimit ngaparagrafi (7) i ketij neni.

(9) Elementet edetyrueshme te shpalljes publike nga paragrafi (1) i ketij neni dhe tefleteparaqitjes nga paragrafi (2) i ketij neni, si formen, permbajtjen dhemenyren e mbajtjes se Regjistrin nga paragrafi (7) i ketij neni i percakton ministri i Administrates Publike.

Zgjedhja ekandidateve

Neni 20-d

(1)Pas procedures se zbatuar te seleksionimit te percaktuar neligjet e posacme, per cdo vend te ndryshem pune nga shpallja publike behetrang-liste e kandidateve te cilet me sukses i kane kaluar te gjitha fazat eseleksionimit.

(2)Nga rang-listat e paragrafit (1) te ketij neni zgjidhen aqkandidate te ranguar me se miri me perkatesi te bashkesise per te cilen ne pajtimme planin vjetore te institucionit jane parapare punesime te reja, aq sarealizues kerkohen per vendet e tilla te punes.

(3)Ne rast kur ne rang-listat e paragrafit (1) te ketij neni nukka kandidate te mjaftueshem me perkatesi te bashkesise per te cilen ne pajtimme planin vjetor te institucionit jane parapare punesime te reja, aq sarealizues kerkohen, shpallja publike perseritet per ato vende pune dhe per atenumer te realizuesve, sa mungojne.

(4)Nese edhe gjate perseritjes se dyte te shpalljes publike, nerang-lista nuk ka kandidate te mjaftueshem me perkatesi te bashkesise per tecilen ne pajtim me planin vjetor te institucionit jane parapare punesime tereja, aq sa realizues kerkohen, perpilohet rang-liste unike ne te cilenrangohen kandidatet nga te gjitha shpalljet e publikuara paraprake per ate vendpune dhe zgjidhen kandidate e ranguar me se miri nga ajo liste, pa marreparasysht perkatesine e tyre te bashkesise.

(5) Nëse në rang-listat nga paragrafi (4) i këtij neni nuk ka kandidatë të mjaftueshëm, shpallja publike në vitin rrjedhës mund të perseritet deri sa vendet e punës nuk plotësohen, me ç'rast në perseritjet e mëtejme zgjidhen kandidatët e ranguar më së miri pa marrë parasysh perkatesinë e tyre të bashkësisë.

(6) Nëse në rang-liste nga ecila duhet të kryhet zgjedhja, të ranguar më së miri janë dy ose më shumë kandidatë me numër të njëjta të pikëve, zgjidhet kandidati i cili ka fituar më shumë pikë në fazën e seleksionimit administrativ.

KAPITULLI V

LLOJET E PUNESIMEVE NE SEKTORIN PUBLIK

Llojet e punesimeve

Neni 21

(1) Marrëdhënien e punës të punësuarit në sektorin publik e themelojnë me lidhje të marrëveshjes për punësim, perkatesisht nëpërmjet aktvendimit për punësim.

(2) Marrëveshja për punësim lidhet, perkatesisht aktvendimi për punësim miratohet për kohë të paktuar, me kohë të plote, perkatesisht të paktë të punës.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, punëdhësi mund të lidhë marrëveshje, perkatesisht të miratojë aktvendim për punësim, me kohë të plote, perkatesisht të paktë të punës.

Punësimi me kohë të caktuar

Neni 22

(1) Personi udhëheqës i institucionit në sektorin publik mund të plotësojë vendin e punës nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes për punësim me kohë të caktuar të punës për:

- zëvendësim të të punësuarit që mungon për kohësisht, i cili mungon më shumë se një muaj,
- vëllim të rritur për kohësisht të punës,
- punë sezonale,
- aktivitete afatshkurtra të paparashikueshme që paraqiten në kryerjen e veprimtarisë kryesore të punëdhënësit,
- punë në projekte ose

- plotesim te vendeve te punes tevecanta ne kabinetet e Presidentit te Republikes se Maqedonise se Veriut, Kryetarit te Kuvendit te Republikes se Maqedonise se Veriut, nenkryetareve te Kuvendit te Republikes se Maqedonise se Veriut, Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut, zevendeskr-yetareve te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut, ministrave, Sekretarit te Pergjithshem te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut, per kryerje te detyrave te punes te keshilltareve te vecante.

(2) Punesimi nga paragrafi (1) alineja 1 e ketij neni zgjate deri ne kalimin emungeses se lejuar te te punesuarit qe mungon, ndersa me se gjati dy vjet.

(3) Punesimi nga paragrafi (1) alinete 2, 3 dhe 4 te ketij neni, zgjate derisa zgjate nevoja e institucionit, ndersame se gjati nje vit.

(4) Punesimi nga paragrafi (1) alineja 5 e ketij neni, zgjat deri ne perfundimin e projektit, ndersa me se gjati pese vjet.

(5) Punesimi nga paragrafi (1) alineja 6 e ketij neni, zgjat deri ne kalimin e mandatit te funksionarit ne kabinetin ete cilit eshte punesuar.

(6) Njesia projektuese dhe vendet epunes ne njesine projektuese ne pajtim me paragrafin (1) alineja 5 te ketij neni, si dhe vendet e punes te keshilltareve te vecante ne perputhje me paragrafin (1) alineja 6 te ketij neni, doemos duhet te percaktohen ne aktetper organizimin e brendshem dhe sistematizimin e vendeve te punes ne institucion.

(7) Keshilltareve te vecante nga paragrafi (1) alineja 6 e ketij neni, u pezullohet marredhenia e punes perkohezgjatjen e marreveshjes per punesim ne kabinet.

(8) Per punesim ne rastet nga paragrafi (1) alinete 1, 2, 3, 5 dhe 6 te ketij neni, personi udheheqes i institucionit publikon shpallje publike, ne pajtim me rregullat e pergjithshme per marredheniet e punes perkatesisht lidh marreveshje per kalimin e te punesuarit me Agjencine per punesime te perkohshme.

(9) Per punesim ne rastin nga paragrafi (1) alineja 4 te ketij neni, per perkohezgjatje deri ne 30 dite, personi udheheqes i institucionit e shpalle nevojën per punesim ne sherbimin kompetent per ndermjetesim gjate punesimit, pa arketim, nepermjet dergimit te personave per punesim nga evidenca e personave te papunesuar ne pajtim me rregullat e pergjithshme per marredhenie te punes.

(10) Personi udheheqes i institucionit mund, ne pajtim me paragrafin (9) te ketij neni, me se shumti dy here ne vit, te punesoje persona nepermjet dergimit nga sherbimi kompetent per ndermjetesim gjate punesimit, me c'rast numri i pergjithshem i te punesuarve nuk guxon te jete me i madh se 5 % nga numri i tegjithe te punesuarve ne institucion, pervec ne raste te jashtezakonshme kur pershkaqe shendetesore ka nevojë per punesim permes dergimit nga sherbimi kompetent per ndermjetesim gjate punesimit, me teper se dy here ne vit, respektivisht numer me te madh te personave, per cfare personi udheheqes i institucionit eshte i obliguar qe te siguroje dokumentacion mjekesor perkates.

(11) Numri i vendeve te punes tevecanta te keshilltareve nga paragrafi (1) alineja 6 te ketij neni nuk mund te jete me i madh se:

- pese vende te punes tekeshilltareve te vecante ne kabinetin e Presidentit te Republikes se Maqedonise se Veriut,
- pese vende te punes tekeshilltareve te vecante ne kabinetin e Kryetarit te Kuvendit te Republikes se Maqedonise se Veriut,
- nje vend pune te keshilltarit te vecante ne kabinetet e nenkryetareve te Kuvendit te Republikes se Maqedonise se Veriut,
- nga nje vend pune te keshilltarite vecante per secilin sektor te Qeverise se Republikes se Maqedonise ne kabinetin e Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut,
- tri vende te punes te keshilltareve te vecante ne kabinetet e Zevendes kryetareve te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut,
- tri vende te punes tekeshilltareve te vecante ne kabinetet e ministrave te cilet udheheqin ministrime mbi 100 te punesuar,
- tri vende te punes te keshilltareve te vecante ne kabinetin e Sekretarit te Pergjithshem te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut,
- dy vende te punes te keshilltareve te vecante ne kabinetet e ministrave te cilet udheheqin ministri me me pak se 100 te punesuar dhe
- nje vend pune te keshilltareve te vecante ne kabinetet e ministrave pa resor.

(12) Ne rastin e lidhjes semarreveshjes per kalimin e te punesuarit me Agjencine per punesime te perkohshme, nga paragrafi (8) i ketij neni, kohezgjatja e marreveshjes per kalim te te punesuarit per kryerjen e puneve te njejta te perkohshme mund telidhet derisa zgjat nevoja, por jo me gjate se nje vit per te punesuarin enejte tek punedhenesi i njejte.

(13) Marreveshjet per punesim ne kohete caktuar ne perputhje me bazat e percaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni, mund te lidhen vetem nese institucioni ka siguruar pelqim se jane siguruarmjete financiare nga organi kompetent per dhenien e pelqimit per planin vjetor per punesim te institucionit lidhur me buxhetin.

(14) Te drejtat dhe detyrimet ngamarredhenia e punes te te punesuarve ne kohe te caktuar rregullohen merregullat e pergjithshme per marredhenie te punes.

(15) Me perjashtim nga paragrafi (2) i ketij neni, nese i punesuari qemungon edhe pas kalimit te dy viteve nuk kthehet ne pune, marredhenia e punes ete punesuarit qe e zevendeson mund te transformohet nga kohe e caktuar ne kohete pacaktuar pas pelqimit paraprak te organit kompetent per dhenien e pelqimit per planin vjetor per punesim te institucionit lidhur me buxhetin.

Punesimi me kohe te paplote te punes

- (1) Koha e plote e punes e tepunesuarve ne sektorin publik eshte 40 ore ne jave.
- (2) Si kohe e paplote e punes konsiderohet kohe qe eshte me e shkurter se kohe e plote, dhe e njejta mund te jete se paku 20, e me se shumti 30 ore ne jave.
- (3) Personi udheheqes i institucionit, me kerkese te te punesuarit ose sipas nevojës se institucionit mund te miratoje aktvendim per kohe te paplote te punes per:
- vellimi te punes te zvogeluar per kohesisht,
 - kujdes per femijen e pare, deri nemoshen e tij dyvjecare,
 - kujdes per femijen e dyte, deri nemoshen e tij dyvjec e gjysme,
 - kujdes per femijen e trete, deri nemoshen e tij trevjecare,
 - kujdesi per femije me probleme ne zhvillim dhe nevoja te vecanta arsimore dhe
 - zvogelim te aftesise se punes, neperputhje me rregullat per sigurim pensional dhe invalidor, rregullat per sigurim shendetesor ose rregullat tjera.
- (4) Ne kushte nga paragrafi (3) alineja 1 e ketij neni, personi udheheqes i institucionit mund te kerkoje nga i punesuari qe te punoje me kohe te paplote te punes, per cfare personi udheheqes i institucionit, me pelqim paraprak te te punesuarit, ne afat prej 15 ditesh miraton aktvendim.
- (5) Ne kushtet nga paragrafi (3) alinete 2, 3 dhe 4 te ketij neni, i punesuari ne sektorin publik mund te paraqese kerkese te personi udheheqes i institucionit per pune me kohe te paplote te punes, nese punon kohe te plote ose e kunderta, per c'fare personi udheheqes i institucionit, ne afat prej 15 diteve mund te miratoje aktvendim.
- (6) Ne kushtet nga paragrafi (3) alinete 5 dhe 6 te ketij neni, i punesuari ne sektorin publik ne baze te aktvendimit nga organi kompetent mund te paraqese kerkese te personi udheheqes i institucionit per pune me orar te paplote te punes, per cfare personi udheheqes i institucionit ne afat prej 15 diteve miraton aktvendim.
- (7) Rroga, kontributet e rroges, shtesat e rroges, pushimi dhe kushtet tjera per te punesuarin qe punon me kohe te paplote te punes, percaktohen ne raport me numrin e oreve javore te punes, pervec ne raste nga paragrafi (3) alinete 5 dhe 6 te ketij neni per te cilat zbatohen dispozitat nga sfera e mbrojtjes shendetesore, sigurimi invalidor ose mbrojtja sociale.

KAPITULLI VI TEDREJTAT E PERGJITHSHME, DETYRAT DHE PERGJEGJESITE DHE NDERPRERJA E MARREDHENIES SE PUNES TE TE PUNESUARVE NE SEKTORIN PUBLIK

Baza e te drejtave dhe detyrave

Neni 24

(1) Te drejtat e pergjithshme dhedetyrat te te punesuarve ne sektorin publik qe rrjedhin nga marredhenia e punesrregullohen me kete ligj.

(2) Me ligjet dhe me marreveshjet kolektive ne perputhje me nenin 3paragrafi (1) te ketij ligji, per te punesuarit ne sektorin publik mund terregullohen edhe te drejtat dhe detyrat tjera qe rrjedhin nga marredhenia epunes.

E drejta e rroges dhe kompensimeve te rroges

Neni 25

Te punesuarit ne sektorit publikper punen e tyre kane te drejte te rroges ne pajtim me ligjet e vecanta,rregullat e pergjithshme per marredheniet e punes dhe marreveshjet kolektive.

E drejta e pushimeve dhe mungesave

Neni 26

Tepunesuarit ne sektorin publik kane te drejte te pushimeve dhe mungesave ngapuna ne pajtim me ligjet e vecanta, rregullat e pergjithshme per marredheniepune dhe marreveshjet kolektive.

E drejta per pune ne kushte perkatese te punes

Neni 27

Te punesuarit ne sektorin publikkane te drejte ne kushte te siguruara organizative, hapesinore dhe teknike perkryerjen e puneve dhe detyrave te punes.

E drejta per persosje profesionale

Neni 28

(1) Te punesuarit ne sektorin publikkane te drejte per persosje te vazhdueshme profesionale, per cfareinstitucionet miratojne programe perkatese.

(2) Sipas nevojës, persosja profesionale mund te realizohet dhe ne gjuhet ebashkesive qe nuk jane shumice ne Republiken e Maqedonise se Veriut.

E drejta per mbrojtje

Neni 29

Te punesuarit nesektorin publik ne realizimin e te drejtave dhe detyrave nga marredhenia epunes kane te drejte te kerkojne mbrojtje para gjykates kompetente, si dhe ngaorgani tjeter kompetent ne pajtim me ligjin.

E drejta per mbrojtje te te punesuarve qe kane paraqitur dyshim ose njohuri per veper penale ose per veprimte paligjshem ose te palejuar

Neni 30

Te punesuarit ne sektorin publik me goje ose me shkrim kane paraqitur dyshim osekane njohuri qe eshte kryer, ose kryhet ose ka gjasa qe te kryhet veper penaleokunder detyres zyrtare ose veprim tjeter i paligjshem ose i palejuar me tecilin rrezikohet interesi publik, siguria dhe mbrojtja, u sigurohet mbrojtje nepajtim me ligjin dhe u garantohet anonimiteti dhe besuesshmeria deri ne shkalledhe ne moment deri ne te cilat ai e kerkon ate.

E drejta per pezullim te marredhenies se punes

Neni 31

(1) Te punesuarve ne sektorin publikte cilet jane emeruar ne funksion publik te percaktuar me ligj, qe cilet jane derguarper pune jashte vendit ne kuader te bashkepunimit nderkombetar, teknik,arsimor, shendetesor, kulturor, shkencor ose llojit tjeter te bashkepunimit,perkatesisht te cilet jane derguar per pune ne perfaqesi diplomatike apokonsullore, u pezullohen te drejtat dhe detyrat nga marredhenia e punes.

(2) Te punesuarit nga paragrafi (1)i ketij neni kane te drejte, qe ne afat prej pese diteve te punes pasnderprerjes se kryerjes se funksionit , ose pas kthimit nga jashte, te kthehenne institucionin nga i cili jane larguar ne vend pune se paku ne nivelin enejte me nivelin ne te cilin kane qene para se te shkojne ne funksionin osejashte vendit.

(3) Te punesuarve bashkeshortet e tecileve jane derguar per pune jashte vendit ne kuader te bashkepunimitnderkombetar, teknik, arsimor, shendetesor, kulturor, shkencor ose llojittjeter te bashkepunimit, perkatesisht te cilet jane derguar per pune neperfaqesi diplomatike apo konsullore, u pezullohen te drejtat dhe detyrat ngamarredhenia e punes.

(4) Te punesuarit nga paragrafi (3) iketij neni kane te drejte qe ne afat prej pese diteve te punes pas nderprerjesse punes te bashkeshorteve te tyre jashte vendit, te kthehen ne institucioninnga i cili jane larguar ne vend pune se paku ne nivelin e njejte me nivelin nete cilin kane qene para se te shkojne jashte vendit.

(5) Te punesuarit ne sektorin publik, me kerkese te tyre, ndersa me pelqim me funksionarin qe udheheq me institucionin, kane te drejte ne mungese te papaguar ne kohezgjatje prej me seshumti dy vjet, per shkak te persosjes profesionale qe nuk financohet nga organi.

(6) Te punesuarve nga paragrafi (5) i ketij neni, per kohezgjatjen e mungeses se papaguar, u pezullohen te drejtat nga marredhenia e punes.

(7) Nese per kohezgjatjen e pezullimit te marredhenies se punes te te punesuarve nga paragrafet (1), (3) dhe (5) te ketij neni, ndryshohen kushtet evecanta per vendin e tyre te punes, te njejtet jane te detyruar t'i plotesoje kushtet e reja ne afat prej dy viteve nga dita e kthimit ne institucion.

E drejta e organizimit sindikal dhe e drejta e greves

Neni 32

(1) Te punesuarit ne sektorin publik, per shkak te realizimit te te drejtave te tyre ekonomike dhe sociale, kane te drejte te perfshihen ne themelimin, formimin dhe te anetaresohen ne sindikateme kusht dhe me procedure te percaktuara me ligj dhe me aktet e sindikates.

(2) Te punesuarit ne sektorin publik kane te drejte te greves te organizuar ne pajtim me Kushtetuten, ligjin, dhe marreveshjet e ratifikuara nderkombetare ne pajtim me Kushtetuten.

(3) Gjate realizimit te se drejtes se greves te punesuarit ne sektorin publik jane te detyruar te sigurojne minimum kryerje te papenguar te funksioneve te institucionit dhe nivel te domosdoshemte realizimit te te drejtave dhe interesave te qytetareve dhe te personave juridike.

(4) Personi udheheqes i institucionit, ne pajtim me ligjin dhe /ose marreveshje kolektive, me akt e percakton menyren e realizimit te kompetencave, perkatesisht veprimtarive me interes publik te institucionit gjate kohes se greves, numrin e te punesuarve qe do t'i realizojne kompetencat gjate kohes se greves, si dhe menyren e sigurimit te kushteve per te drejten e greves nga paragrafi (3) i ketij neni.

E drejta e kandidimit ne zgjedhje

Neni 33

(1) Te punesuarit ne sektorin publik kane te drejte te kandidohen ne zgjedhje parlamentare, presidenciale dhe lokale.

(2) Te punesuarit ne sektorin publik kane te drejte te mungeses se papaguar gjate kohes se fushates zgjedhore perzgjedhjet nga paragrafi (1) i ketij neni ne te cilat marrin pjese.

(3) Percaktimi politik dhe mendimi politik i te punesuarve ne sektorin publik te shprehura gjate kohes se mungeses se papaguar gjate fushates zgjedhore nuk guxojne te ndikojne ne statusin e tyre, ne te drejtat e tyre dhe detyrimet.

Detyra per kryerje te puneve dhe te detyrave te punes

Neni 34

(1) Te punesuarit ne sektorin publik jane te detyruar t'i kryejne punet dhe detyrat e punes, te pershkruara ne aktin per sistematizim te vendeve te punes ne institucion.

(2) Te punesuarit ne sektorin publik, ne baze te detyrimit ne forme teshkruar nga eprori i drejtperdrejte, ose nga personi udheheqes i institucionit, jane te detyruar te kryejne edhe pune dhe detyra te punes te cilat nuk jane tepermbajtura ne pershkrimin e paragrafit (1) te ketij neni, ndersa te cilat jane perkatese me kualifikimet e tyre profesionale dhe me kompetencat e punes.

Detyrimi per sugjerim per detyra te paligjshme te punes

Neni 35

(1) Te punesuarit ne sektorin publik jane te detyruar per realizojne detyrat e punes te dhena nga funksioneri qe udheheq me institucionin, perkatesisht menaxhuesi i drejteplerdrejte dhe teveproj mbi ta ne pajtim me Kushtetuten, ligjin ose rregullore te tjera.

(2) Nese te punesuarit konsiderojne se detyra e dhene e punes nga paragrafit (1) te ketij neni nuk eshte ne pajtim me Kushtetuten, me ligjin dhe me rregull tjeter jane te detyruar qe per kete t'isugjerojne personit qe ua ka dhene detyren.

(3) Te punesuarit jane te detyruar teveprojne sipas detyres se punes nga paragrafi (2) te ketij neni, te dhene ne forme me shkrim, pervec nese vleresojne se kryerja e saj paraqet veper penale dhe menjehere per kete ta njoftojne me shkrim eprorin e drejteplerdrejte me telarte nga ai qe ua ka dhene detyren, si dhe Komisionin Shtetror per Parandalimin e Korrupsionit.

(4) Nese te punesuarit nuk e paralajmerojne eprorin e drejtperdrejte se detyra eshte jokushtetuese, perkatesisht e paligjshme dhe e kryejne, ata do te pergjigjen per kryejnen esaj, si edhe eprori i drejtperdrejte.

(5) Te punesuarit nuk mund te thirren per pergjegjesi per shkak te njoftimit te dhene nga paragrafi (3) te ketij neni.

Detyrimi per njoftim per mungese nga puna

Neni 36

(1) Te punesuarit ne sektorin publik jane te detyruar ta respektojne kohen e punes te punedhenesit.

(2) Ne rast te pengimit per te ardhurne pune, te punesuarit duhet ta njoftojne eprorin e drejteperdrejte, perkatesisht personin udheheqes te institucionit, deri ne kalimit e kohesditore te punes te punedhenesit.

(3) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, kur pengimi per ardhje nepune eshte krijuar nga fuqia madhore, njoftimin per pengim per ardhje ne pune, te punesuarit detyrohen ta dorezojne menjehere pas nderprerjes se shkakut qe eka pamundesuar njoftimin.

Detyrimi per veprim sipas kerkeses per dergim

Neni 37

(1) Ne rast te rrethanave tejashtezakonshme (fatkeqesite natyrore, epidemi, vershime e ngjashem), tepunesuarit ne sektorin publik pa pelqimin e tyre mund te dergohen ne kryerje tepunes dhe te detyrave te punes te punedhenesi jashte vendbanimit te tyre.

(2) Dergimi nga paragrafi (1) i ketijneni zgjat deri sa te zgjasin rrethanat e jashtezakonshme por jo me gjate setre muaj.

(3) Ne rastet e dergimit per kryerje te puneve dhe te detyrave te punes ngaparagrafi (1) i ketij neni, te punesuarit kane te drejte per kompensime tepercaktuara me rregullat e pergjithshme per marredhenie pune.

Ndalimi per veprim politik ne vendin e punes

Neni 38

(1) Te punesuarit ne sektorin publik, me anetaresimin ne parti politike dhe me pjesemarrje ne aktivitete partiake, nuk guxojne ta vene ne pikepyetje kryerjen e puneve dhe te detyrave te punes nga vendi i punes ne institucion.

(2) Te punesuarit, gjate kryerjes sepuneve dhe te detyrave te punes nuk guxojne t'i shprehin apo t'i paraqesin bindjet e tyre politike dhe partiake.

(3) Te punesuarit, gjate kohes sepunes nuk guxojne te marrin pjese drejtperdrejt ne aktivitete zgjedhore ose nengjarje te tjera publike te atij lloji.

(4) I punesuari, ne institucionin ne te cilin i kryen punet dhe detyrat epunes nuk guxon ne vete te mbaje ose te vendose simbole partiake ne lokalet epunes dhe ne lokalet e institucionit.

Ndalimi per pranim te dhuratave

Neni 39

(1) Te punesuarit ne sektorin publik nuk guxojne te pranojne dhurata te lidhura me punen e tyre, me perjashtim tedhuratave protokollare, dhe te perkohshme me ne vlere me te ulet. Dhurata tecilat nuk e tejkalojne vleren e 1 000 denareve, ose dhurata te marra ngapersoni i njejte vlere e pergjithshme e se ciles nuk tejkalon 3 000 denare nevitin e dhene, konsiderohen dhurata me vlere me te ulet. Dhuratat e pranuaranga ana e personave zyrtare ose nga organizata nderkombetare, te dhena gjatevizitave, te qenet mysafir ose rrethana tjera te ngjashme, konsiderohen dhurataprotokollare.

(2) Ndalimi dhe kufizimet epercaktuara ne paragrafin (1) te ketij neni gjithashtu kane te bejne edhe mebashkeshortin e te punesuarit, personat qe jetojne se bashku me te punesuarinne bashkesi jashtemartesore, me femijet e tyre, prinderit dhe personat qejetojne ne ekonomi te njejte familjare.

(3) Te punesuarit ne sektorin publikjane te detyruar t'i paralajmerojne dhuruesit qe dhuratat qe e tejkalojnevleren e percaktuar ne paragrafin (1) te ketij neni, behen pronesi epunedhenesit. Ne rast qe dhuruesi te insistoje per pranim te dhurates, ipunesuar, ose personat nga paragrafi (2) te ketij neni detyrohen ta dorezojnedhuraten te punedhenesi.

(4) Te dhenat per dhuratat e pranuar, vleren e tyre, dhuruesit dhe rrethanat tjera futen ne evidencen e dhuratave. Tepunesuarit gjithashtu jane te detyruar qe t'i paraqesin te dhenat qe duhet tefuten ne rastet nga paragrafi (2) te ketij neni.

(5) Menyra e disponimit me dhuratat nga paragrafi (3) i ketij neni, menyrae menaxhimit me evidencen nga paragrafi (4) i ketij neni, dhe ceshtje tjera nelidhje me pranimin e dhuratave, rregullohet me dekret te Qeverise.

Pergjegjesia per kryerjen e puneve dhe te detyrave te punes

Neni 40

(1) Te punesuarit ne sektorin publikjane personalisht pergjegjes per kryerjen e puneve dhe te detyrave te punes ngavendi i punes.

(2) Pergjegjesia e te punesuarve ngaparagrafi (1) i ketij neni mund te jete disiplinore dhe/ose materiale.

(3) Pergjegjesia per veper te kryerpenale, perkatesisht kundervajtje nuk e perjashton pergjegjesine disiplinore tete punesuarve.

(4) Pergjegjesia disiplinore dhe/ose materiale e te punesuarve ne sektorin publik, percaktohet me ligj.

Nderprerja e marredhenies se punes

Neni 41

Tepunesuarve ne sektorin publik marredhenia e punes u nderpritet me marreveshje, me kerkese te tyre, me fuqi te ligjit dhe ne raste tjera te percaktuara me ligj dhe/ose marreveshje kolektive.

KAPITULLI

VII

MOBILITETI I TE PUNESUARVE NE SEKTORIN PUBLIK

Mobiliteti

Neni 42

(1) Mobiliteti eshte levizja horizontale e te punesuarit nga nje vend pune ne tjetër ne suaza te grupit tenjte te vendeve te punes, te percaktuar me kete ligj.

(2) Mobiliteti kryhet nepermjetsistemimit, perkatesisht marrjes se te punesuarit ne vendin e punes ne niveline njete , perkatesisht ne vendin e punes per te cilin i punesuari i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara ne aktin e sistematizimit te vendeve te punes ne institucionin ne te cilin sistemohet ose merret.

(3) Me perjashtim nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni, per te punesuarit permes K5 Programit ne Ministria per Sistem Politik dhe Marredhenie Ndermjet Bashkesive mobiliteti kryhet me marrje te te punesuarit ne vendin e punes ne nivel te njete, perkatesisht ne vendin e punes per te cilin i punesuari i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara me aktin per sistematizim te vendeve te punes ne institucionin ne te cilin merret, me pelqim paraprakisht te Ministrise se Shoqerise Informatike dhe Administrates dhe organit kompetent per buxhetin e institucionit ne te cilin i punesuari merret.

(4) Mobiliteti kryhet pa publikim te shpalljes interne, perkatesisht publike.

Mobiliteti permes sistemimit

Neni 43

(1) Te punesuarit ne sektorin publik, me kerkese tetij ose sipas nevojës se institucionit , mund te sistemohet ne menyre teperhershme ne vend tjetër te punes ne nivel te njete, perkatesisht ne vendpune per te cilin i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara ne aktin per sistematizim, per cfare personi udheheqes i institucionit, miraton aktvendim per sistemimin e tij ne institucion.

(2) Te punesuarit ne sektorin publik, me kerkese te institucionit tjetër per shkak te vellimit te zmadhuar perkohesisht te punes, mund te sistemohet perkohesisht ne vendin e punes per te cilin i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara ne aktin per sistematizim te institucionit tjetër.

(3) Sistemimi nga paragrafi (2) i ketij neni kryhet me pelqimin paraprak me shkrim te te punesuarit dhe te personave udheheqes te institucioneve, ndersa aktvendimin per sistemimin

perkohezgjitje prej se paku nje muaji e me se shumti nje vit, e miraton personi udheheqes i institucionit ne te cilin ai eshte i punesuar.

(4) Vendi i punes ne te cilin sistemohet i punesuari nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni nuk guxon te jete ne largesi me shume se 50 kilometra ngavendin e punes ne te cilin i njejti ka qene i punesuar para sistemimit.

Mobiliteti nepermjet marrjes

Neni 44

(1) I punesuari ne sektorin publik, me kerkese te tij, sipas nevojës se institucionit ne te cilin eshte i punesuar ose sipas nevojës se institucionit tjetër mund te merret ne menyre te perhershme ne vend pune te nivelit tenjejte, perkatesisht ne vend pune per te cilin i ploteson kushtet pergjithshmedhe te vecanta te percaktuara ne aktin per sistematizim te institucionit tjeternese per kete pajtohen i punesuari dhe personat udheheqes te te dyja institucioneve, e pas pelqimit paraprak te Ministrise se Administrates Publike dhe organit kompetent per dhenien e pelqimit per planin vjetor per punesim te institucionit lidhur me buxhetin.

(2) Per shkak te nevojave per mobilitetin te te punesuarve ne sektorin publik, Ministria e Administrates Publike pergatit dhe mban transfer-lista te marrjeve te mundshme.

(3) Institucioni i cili shuhet, transformohet, ose kompetenca e te cilit zvogelohet, detyrohet te paraqese liste te te punesuarve vendet e punes te tecileve jane hequr, e te cilet Ministria e Administrates Publike i fut ne listen nga paragrafi (2) i ketij neni.

(4) I punesuari vendi i punes i te cilit hiqet, evidentohet ne listen nga paragrafi (2) i ketij neni, dhe mund te merret ne institucion tjetër, ne vend pune ne nivel te njejte, perkatesisht ne vend te punes per te cilin qe i ploteson kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te percaktuara ne aktin per sistematizim, nese per kete pajtohen i punesuari dhe personi udheheqes i institucionit tjetër, e pas pelqimit paraprak te Ministrise se Administrates Publike dhe organit kompetent per dhenien e pelqimit per planin vjetor per punesim te institucionit lidhur me buxhetin.

(5) Institucioni ne te cilin merret i punesuari nga paragrafet (1) dhe (4) te ketij neni nuk guxon te jete ne largesi me shume se 50 kilometra nga institucioni ne te cilin i njejti ka qene i punesuar para marrjes.

(6) Kufizimi i paragrafit (5) te ketij neni nuk vlen nese marrja eshte me kerkese te te punesuarit.

(7) Te punesuarit i cili nuk do ta neshkruaje marreveshjen e ofruar nga paragrafi (4) te ketij neni, ne afat prej pese ditesh nga data ne te cilen ieshte dorezuar do t'i nderpritet marredhenia e punes.

(8) Formen dhe permbajtjen e listes nga paragrafi (2) i ketij neni, si dhe menyren e mbajtjes, menyren e qasjes, si dhe pergjegjesine per autenticitetin dhe sigurine e te dhenave, i percakton ministri i Administrates Publike.

KAPITULLI VIII

MBIKEQYRJE MBIZBATIMIN E LIGJIT

Mbikeqyrja

Neni 45

- (1) Mbikeqyrje mbi zbatimin e ketijligji kryen organi i administrates kompetent per punet e administratesshteterore.
- (2) Mbikeqyrje inspektuese mbizbatimin e dispozitave te ketij ligji, si dhe te rregullave te miratuara ne baze te ketij ligji, per te punesuarit ne sektorin publik nga neni 14 paragrafi(1) alinete 1 dhe 2 te ketij ligji, kryen Inspektorati Shteteror Administrativ.
- (3) Mbikeqyrje inspektuese mbizbatimin e Kapitullit IV-a te ketij ligji kryen Inspektorati ShteterorAdministrativ, i cili eshte i obliguar qe nje here ne vit te kryej mbikeqyrjete rregullt inspektuese ne te gjitha institucionet e sektorit publik.
- (4) Mbikeqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave te ketij ligji, sidhe te rregullave te miratuara ne baze te ketij ligji, per te punesuarit ne sektorin publik nga neni 14 paragrafi (1) alinete 3 dhe 4 te ketij ligji, kryenInspektorati Shteteror i Punes.

KAPITULLI IX

DISPOZITA KUNDERVAJTESE

Gjoba

Neni 46

Gjobe ne shume prej 250 deri 500 euro ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet per kundervajtje funksionariti cili udheheq me institucionin nese:

- nuk e zbaton proceduren permiratimin e aktit per sistematizim ose nuk e miraton aktin per sistematizim, nepajtim me nenin 17 te ketij ligji,
- nuk autorizon se paku nje personper menaxhimin me te dhenat ne SIMRNj ose per kete nuk e njofton Ministrine e Administrates Publike, ne pajtim me nenin 19 paragrafin (5)te ketij ligji,
- nuk e miraton planin vjetor perpunesime ose zbaton procedure per punesim pa plan vjetor, ne pajtim me nenin20-a paragrafi (1) te ketij ligji,

- nuk fut te dhena te sakta per gjendjen rrjedhese te plotesimit te vendeve te punes dhe pensionimeve te planifikuara, ne pajtim me nenin 20-aparagrafi (2) alineja 1 dhe 2 te ketij

ligji,

- nuk e zbaton proceduren permiratimin e planit vjetore per punesime, ne pajtim me nenin 20-b te ketijligji,

- nuk dorezon raporte per realizimine planit vjetor per punesime, ose ne raporte fut te dhena te rrejshme ne pajtimme nenin 20-v paragrafet (1) dhe (2) te ketij ligji,

- nuk kryen zgjedhje ne pajtim meplanin, ne pajtim me nenin 20-d te ketij ligji,

- punesimi ne kohe te caktuar per shkak te zevendesimit te punesuarit qemungon perkohesisht, i cili mungon me shume se nje muaj, zgjate me gjate seafati i percaktuar ne nenin 22 paragrafi (2) te ketij ligji,

- punesimi ne kohe te caktuar pershkak te vellimit te rritur perkohesisht te punes, pune sezonale, perkatesishtaktivitete te paparapara afatshkurtra qe paraqiten ne kryerjen e veprimtarisekryesore te punedhenesit, zgjate me gjate se afati i percaktuar ne nenin 22paragrafi (3) te ketij ligji,

- punesimi ne kohe te caktuar pershkak te punimit te projektit, zgjate derisa zgjate projekti, por jo me gjatese afati i percaktuar ne nenin 22 paragrafi (4) te ketij ligji,

- punesimi ne kohe te caktuar perkryerje te detyrave te punes te keshilltareve te vecante, zgjate me gjate seafati i percaktuar ne nenin 22 paragrafi (5) te ketij ligji,

- me shume se dy here ne vit punesonpersona nepermjet dergimit nga sherbimi kompetent per ndermjetesim gjatepunesimit ose numri i pergjithshem i personave te punesuar nepermjet dergimitte sherbimit kompetent per ndermjetesim gjate punesimit eshte me i madh se 5%nga numri i te gjitha te punesuarve ne institucion, ne pajtim me nenin 22paragrafi (10) te ketij ligji dhe

- lidh marreveshje per kalim te te punesuarit me Agjencine per Punesimete Perkohshme, me gjate se nje vit me te punesuar te njejte ne institucionin enejte, ne pajtim me nenin 22 paragrafi (11) te ketij ligji.

Neni 46-a

(1)Per kundervajtje percaktuar ne nenin 46 te ketijligji, inspektori administrativ per te punesuarit ne sektorin publik nga neni 14 paragrafi (1) alinete 1 dhe 2 te ketij ligji respektivisht inspektori ipunes per te punesuarit ne sektorin publik nga neni 14 paragrafi (1) alinete 3dhe 4 te ketij ligji eshte obliguar kryeresit te kundervajtjes t'i leshojeurdherpagese ne pajtim me Ligjin per kundervajtje.

(2)Inspektori administrativ respektivisht i puneseshte i obliguar te mbajne evidence per urdher pagesa te leshuara kundervajtesedhe per epilogun e procedurave te ngritura

(3) Ne evidencen sipas paragrafit (2) te ketij neni mblidhen, perpunohen dhe ruhen te dhenat per proceduren per leshimin e urdherpageses se kundervajtjes (numri rendor, numri dhe data e procesverbalit te kundervajtjes dhe kualifikimi juridik i kundervajtjes), te dhenat per kryeresin e kundervajtjes (emri dhe mbiemri ose emertimi i kryeresit, adresa/selia e kryeresit dhe numri i amzes / NUT i kryeresit (per te huajin regjistrohet numri i dokumentit te udhetimit)) dhe per proceduren e ekzekutimit (numri dhe data e urdherpageses; shuma e gjobes (ne euro); afati i pageses vullnetare te gjobes; arketimi i gjobes (po/jo) dhe data e parashtrimit te kerkeses per iniciimin e procedures se kundervajtjes).

(4) Te dhenat personale nga paragrafi (3) i ketij neniruhet pese vjet nga dita e futjes ne evidence.

(5) Formen dhe permbajtjen e urdherpageses kundervajtesei percakton ministri i Administrates Publike.

Neni 46-b

Perkundervajtjet e percaktuara me kete ligj procedure kundervajtese mban edhesanksion kundervajtes shqipton gjykata kompetente.

KAPITULLI X

DISPOZITAKALIMTARE DHE TE FUNDIT

Mbajtja e Katalogut

Neni 47

Ministria e Shoqerise Informatikedhe Administrates do ta vendos Katalogun e vendeve te punes ne sektorin publikme se voni nente muaj nga dita e hyrjes ne fuqi e ketij ligji.

Themelimi i Regjistrit

Neni 48

Ministria e Shoqerise Informativedhe Administrates do ta themeloje Regjistrin per te punesuarit ne sektorinpublik ne afat prej nje viti nga dita e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Harmonizimi i ligjeve

Neni 49

Ligjet qe rregullojne ceshtje tecilat jane lende e rregullimit te ketij ligji, do te harmonizohen me dispozitate ketij ligji me se voni nente muaj nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Harmonizimi i akteve per organizim te brendshem dhe akteve per sistematizimin e vendeve te punes

Neni 50

Institucionet e sektorit publik, aktet per organizim te brendshem dhe aktet per sistematizim te vendeve te punes do t'i harmonizojne me dispozitat e ketij ligji me se voni deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Miratimi i akteve nenligjore

Neni 51

Aktet nenligjore te parapara me kete ligj do te miratohen ne afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Metodologjia per planifikim te punesimeve dhe planeve vjetore per punesim

Neni 52

(1) Metodologjia per planifikim te punesimeve ne sektorin publik do te miratohet ne afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

(2) Planet vjetore per punesim institucionet do t'i miratojne ne afat prej nente muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Hyrja ne fuqi

Neni 53

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e tete nga dita e botimit ne “Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise”, e do te filloje te zbatohet pas kalimit te nje viti nga dita e hyrjes se tij ne fuqi.

DISPOZITA TE VLEFSHME KALIMTARE NGA NOVELAT E LIGJIT

I. “Gazetazyrtare e Republikes se Maqedonise”, nr.199/2014

Neni 8

Aktet per zbatimin e ketij ligji do temiratohen deri ne ditin e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Neni 9

(1) Neni17 paragrafi (5) i ketij ligji do te filloje te zbatohet nga viti 2019.

(2) Deri ne skadimin e afatit nga paragrafi (1) i ketij neni, ne aktin per sistematizimin e vendeve te punes ne institucion, mundte sistematizohen me se shumti 50% per vitin 2015, 40% per vitin 2016, 30% pervitin 2017 dhe 20% per vitin 2018, me shume vende pune nga vendet e punes perte cilat jane siguruar mjete financiare per rroga dhe kompensime ne buxhetin einstitucionit per vitin perkates.

Neni 10

(1) Te punesuarit tecilet deri ne ditin e fillimit me zbatim te ketij ligji, jane sistemuar nevendet e punes per te cilat nuk e plotesojne kushtin e vecante per kualifikimeprofesionale lidhur me llojin dhe shkallen e arsimit per nivelin e vendit tepunes ne te cilin jane sistemuar, dhe qe eshte percaktuar me ligje te vecanta,marreveshje kolektive ose me aktet per sistematizim, jane te obliguar taplotesojne kushtin ne afat prej shtate vitesh nga dita e fillimit me zbatimin eketij ligji, pervec nese me ligjet e vecanta nuk eshte rregulluar ndryshe.

(2) Te punesuarit tecilet nuk do ta plotesojne kushtin e vecante ne afatin e percaktuar neparagrafin (1) te ketij neni, me se voni deri me 1 mars te vitit 2022 do tesistemohen ne vende pune per te cilat e plotesojne kushtin.

(3) Paragrafi (1) i ketij neni nuk vlen per te punesuarit te cilet do te realizojne te drejte te pensionitne afat prej dhjete vitesh nga dita e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Neni 11

(1) Planet vjetore perpunesim per vitin 2015 institucionet do t'i perpilojne ne pajtim meMetodologjine e nenit 5 paragrafi (3) i ketij ligji, dhe ne suaza te mjeteve teparapara per rroga dhe kontribute ne buxhetin e institucionit per vitin 2015dhe me se voni deri me 31 janar 2015 do t'i dorezojne per mendim te Ministria eShoqerise Informatike dhe Administrates, e cila eshte e obliguar te jape mendimne afat prej 20 ditesh nga pranimi, ne te kunderten konsiderohet se eshte dhenemendim pozitiv.

(2) Ne rast kur behetfjale per organ te administrates shteterore institucionet jane te obliguara qeplanet per vitin 2015 t'i perpilojne dhe t'i dorezojne per pelqim paraprak te Sekretariati per Zbatimin e Marreveshjes Kornize me se voni deri me 31 janar, icili eshte i obliguar te jape pelqim perkatesisht verejtje ne afat prej 20 ditesh nga dita e pranimi, ne te kunderten konsiderohet se pelqimi eshtedhene.

(3) Ne rastet ngaparagrafi (2) i ketij neni pas marrjes se pelqimit, perkatesisht pasharmonizimit te planit me verejtjet nga Sekretariati per Zbatimin e Marreveshjes Kornize, e me se voni deri me 20 shkurt 2015, organet e administrates shteterore jane te obliguara t'i dorezojne planet te Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates, e cila eshte e obliguar te jape mendim ne afat prej 20 ditesh nga pranimi, ne te kunderten konsiderohet se eshte dhenemendim pozitiv.

(4) Ne vitin 2015, shpallja publike per punesim mund te publikohet vetem pas mendimit te marrepozitiv per planin vjetor nga Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates, dhe pas njoftimit paraprak per mjete financiare te siguruar per punesim ne ate vend pune nga Ministria e Financave, perkatesisht nga organikompotent per leshimin e pelqimit financiar per punesim, nese eshte percaktuar me kete ligj ose me ligj tjeter ose me akt te institucionit.

Neni 12

Neni 11 do te filloje te zbatohet me ditene hyrjes ne fuqi te Metodologjise per planifikimin e punesimeve ne sektorin publik ne pajtim me parimin per perfaqesim adekuat dhe te drejte.

DISPOZITA TE VLEFSHME KALIMTARE NGA NOVELAT E LIGJIT

I. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise", nr. 199/14

Neni 9

(1) Neni 17 paragrafi (5) i ketij ligji do te filloje te zbatohet nga viti 2019.

(2) Deri ne skadimin e afatit ngaparagrafi (1) i ketij neni, ne aktin per sistematizimin e vendeve te punes ne institucion, mund te sistematizohen me se shumti 50% per vitin 2015, 40% per vitin 2016, 30% per vitin 2017 dhe 20% per vitin 2018, me shume vende pune ngavendet e punes per te cilat jane siguruar mjete financiare per rroga dhe kompensime ne buxhetin e institucionit per vitin perkates.

Neni 10

(1) Te punesuarit te cilet deri nediten e fillimit me zbatim te ketij ligji, jane sistemuar ne vendet e punes perte cilat nuk e plotesojne kushtin e vecante per kualifikime profesionale lidhurme llojin dhe shkallen e arsimit per nivelin e vendit te punes ne te cilin janesistemuar, dhe qe eshte percaktuar me ligje te vecanta, marreveshje kolektiveose me aktet per sistematizim, jane te obliguar ta plotesojne kushtin ne afatprej shtate vitesh nga dita e fillimit me zbatimin e ketij ligji, pervec neseme ligjet e vecanta nuk eshte rregulluar ndryshe.

(2) Te punesuarit te cilet nuk do taplotesojne kushtin e vecante ne afatin e percaktuar ne paragrafin (1) te ketij neni, me se voni deri me 1 mars te vitit 2022 do te sistemohen ne vende puneper te cilat e plotesojne kushtin.

(3) Paragrafi (1) i ketij neni nuk vlen per te punesuarit te cilet do terealizojne te drejte te pensionit ne afat prej dhjete vitesh nga dita efillimit te zbatimit te ketij ligji.

Neni 12

Neni 11 do te filloje te zbatohet me ditën e hyrjes ne fuqi te Metodologjise per planifikimin e punesimeve ne sektorin publik ne pajtim me parimin per perfaqesim adekuat dhe te drejte.

II. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise", nr. 198/18

Neni 3

(1) Ne institucionin ne te cilin deri ne ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji nuk eshte miratuar plan per punesim per vitin 2019 ne pajtim me nenin 20-b te Ligjit per te punesuarit ne sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), funksionari i cili udheheq me institucionin eshte i obliguar te pergatise propozim-plan dhe ne afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit te buxhetit te institucionit per vitin 2019 t'ia dorezoje per pelqim organit kompetent per buxhetin e institucionit, respektivisht ne:

- Ministrine e Financave, per institucionet shfrytezues buxhetore te linjes se pare qe financohen nga Buxheti i Republikes se Maqedonise dhe per ndermarrjet publike te themeluara nga Republika e Maqedonise,

- ministrine kompetente, per institucionet qe kryejne veprimtari ne fushen e arsimit dhe shkences, shendetesise, kultures, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes se femijes, si dhe ne aktivitete tjera me interes publik te percaktuar me ligj,

- Keshillin e Komunes per njesite e veteqeverisjes lokale dhe ndermarrjet publike dhe institucionet e themeluara nga njesite e veteqeverisjes lokale dhe

- organ tjetër nese eshte percaktuar me ligj.

(2) Organet kompetente per buxhetin e institucionit jane te detyruara te japin pelqim, perkatesisht te japin verejtje lidhur me propozim-planin me se voni ne afat prej 15 ditesh nga pranimi i propozim-planit.

(3) Funksionari i cili udheheq me institucionin eshte i obliguar te veproje sipas verejtjeve te dhena nga organi kompetent per buxhetin, perkatesisht ta harmonizojë propozim-planin.

(4) Pas marrjes se pelqimit, perkatesisht pas harmonizimit te propozim-planit, funksionari i institucionit eshte i obliguar menjehere dhe me se voni ne afat prej 15 ditesh nga marrja e pelqimit, respektivisht pas harmonizimit te propozim-planit ta miratoje planin dhe te njejtin ta dorezoje per mendim ne Ministrine per Shoqeri Informatike dhe Administrate.

(5) Me perjashtim te paragrafit (1) te ketij neni, funksionari i institucionit per te cilin nuk ka organ qe jep pelqim te buxhetit, planin vjetor e miraton dhe e dorezon ne Ministrine per Shoqeri Informatike dhe Administrate, ne afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit te buxhetit te institucionit per vitin 2019.

(6) Me perjashtim te paragrafit (4), nese behet fjale per organ te administrates shteterore, funksionari eshte i obliguar qe menjehere pas harmonizimit te propozim-planit me organin kompetent per buxhetin, dhe me se voni ne

afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes se pelqimit, respektivisht pas harmonizimit te propozim-planit te kerkoje miratim nga Sekretariati per Zbatimin e Marreveshjes Kornize, per cfare i njejti eshte i obliguar t'i pergjigjet ne afat prej 15 ditesh, respektivisht te jape pelqim nese ndarja e punesimeve te reja te planifikuara per perkatesine e komunitet eshte bere ne perputhje me nenin 20-a paragrafi (6) te ketij ligji ose te jape verejtje lidhur me planin.

(7) Ne rastet nga paragrafi (6) i ketij neni, funksionari eshte i obliguar qe menjehere e me se voni deri me 1 mars ta dorezoje planin e harmonizuar per mendim ne Ministrine per Shoqeri Informatike dhe Administrate, nese plani vjetor eshte pergatitur ne perputhje me Metodologjine.

(8) Ministria per Shoqeri Informatike dhe Administrate eshte e obliguar qe ne afat prej nje muaji te veproje per kerkesat nga paragrafet (4), (5) dhe (7) te ketij neni dhe te jape mendim, dhe nese vertetohet se plani nuk eshte ne perputhje me mendimin e organit kompetent per buxhetin dhe/ose nese ndarja e punesimeve te reja te planifikuara sipas perkatesise se komunitetit nuk eshte bere ne perputhje me nenin 20-a paragrafi (6) te ketij ligji, mendimi do te jete negativ dhe institucionit do t'i jape afat shtese prej 15 ditesh nga dita e mendimit te marre te dorezoje plan te harmonizuar.

(9) Nese edhe pas skadimit te afatit nga paragrafi (8) i ketij neni, funksionari i institucionit nuk dorezon plan te harmonizuar ne Ministrine per Shoqeri Informatike dhe Administrate dhe nuk merr mendim pozitiv, institucioni nuk do te mund te zbatoje proce dura per punesime te reja.

(10) Nese organi kompetent per buxhetin e institucionit ose Sekretariati per Zbatimin e Marreveshjes Kornize nuk veprojne per kerkesen per pelqim ne afatet e percaktuara ne paragrafet (2) dhe (6), do te konsiderohet se pelqimi eshte dhene.

(11) Plani per te cilin eshte marre mendim pozitiv nga Ministria per Shoqeri Informatike dhe Administrate mund te ndryshohet gjate vitit te cilit i referohet vetem me pelqimin paraprak te marre nga organet kompetente per dhenien e pelqimit.

(12) Ministria per Shoqeri Informatike dhe Administrate eshte e obliguar qe perfundimisht me 1 maj 2019 t'i dorezoje mendimet pozitive per planet e institucioneve per vitin 2019 te organet kompetente per buxhetin e institucioneve dhe te Agjencia per Administrate, ndersa per organet e administrates shteterore edhe ne Sekretariatit per Zbatimin e Marreveshjes Kornize.

III. "Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise se Veriut", nr. 302/20 (Ligji i transferit te nepunesve administrative te punesuar nepermjet programit K-5 ne Ministrine e sistemit politik dhe marredhenieve ndermjet bashkesive)

Neni 9

Me ditën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, shfuqizohet dispozita sipas nenit 42 paragrafi (3) e Ligjit te Punesuarve ne Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe („Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise se Veriut“ numer 143/19 dhe 14/20).